



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1025/6 prot.

Datë 29.04.2026

**V E N D I M**

**Nr. 564/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.04.2026 u shqyrtua ankesa me

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TRIOS” SHA në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-73740-01-09-2026, me objekt: “*Blerje lëndë djegëse për përdorim teknik, civil dhe industrial*”, me fond limit 54,999,962 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, me adresë: Rruga “5 Maji”, Tiranë

**Ankimues:** Operatori ekonomik “RESULI - ER” SHA, me NUIS L12510413V, me adresë: Lagjja Mbrostar Ferko, rruga Baltës banesa nr-53, zone kadastrale nr-3980 numer pasurie nr- 62/24, Fier

**Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “TRIOS” SHA, me NUIS L12805203J, me adresë: Rruga Belul Hatibi 232 , prane xhamisë Xhura, porcelan, kati i pare (zyre kontabiliteti per nevojat e shoqerise, Tirane.

**Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.01.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-73740-01-09-2026, me objekt: “*Blerje lëndë djegëse për përdorim teknik, civil dhe industrial*”, me fond limit 54,999,962 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Krugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë.

II.2. Në datën 13.03.2026 autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave. Ofertuesit janë njoftuar elektronikisht si vijon:

1. “TRIOS ” SHA marzh fitimi 11.31 lekë/litër, kualifikuar
2. “RESULI-ER SHA marzh fitimi 19.45 lekë/litër, kualifikuar

II.3. Në datën 27.03.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 02.04.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6476 dhe nr. 1025/2026 protokoli, datë 03.04.2026 e operatorit ekonomik “RESULI - ER” SHA për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-73740-01-09-2026, me objekt: “*Blerje lëndë djegëse për përdorim teknik, civil dhe industrial*”, me fond limit 54,999,962 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Krugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TRIOS” SHA në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

*“I. Ankimojme vlerësimin e KVO pasi operatori TRIOS sha nuk ploteson kriterin:*

*Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon depozita në pronësi ose me qira, faktuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale, akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj) duke vërtetuar kapacitetet depozituese dhe rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për depozitat Vërtetim teknik nga ISHTI ose nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), leje mjedisore sipas legjislacionit në fuqi të lëshuar nga QKL, Akt Teknik të lëshuar nga PMNZH dhe policë sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri.*

*Kjo pasi dyshojme se nuk ka kapacitete prej 447.518 kg ose 447,5 ton mazut, duke mos vërtetuar kapacitetet depozituese dhe rezervat e operatorit ekonomik e duke mos garantuar vazhdimësinë e*

furnizim sic kerkon kriteri. Per kete dokumenti zyrtar ku shenohen kapacitetet eshte vertetimi teknik i leshuar nga OMVK perkatese pasi sipas ligjit Nr.8450, date 24.2.1999 "Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, te gazit dhe nenprodukteve te tyre", i ndryshuar neni 10 mazuti eshte kategori me vete *Kategoria V A. Bitum (asfalt), B. Mazut.*

*Neni 10*

*Ne kuptim te ketij ligji, nafta, gazi natyror dhe nenproduktet e tyre klasifikohen ne kategori, si vijon:*

*Kategoria O*

*A. Nafta bruto*

*B. Gazi natyror*

*Kategoria I*

*A. Gazi i lengshem*

*Kategoria II*

*A. Benzine automjetesh*

*B. Benzine mjetesh te fluturimit ajror*

*C. Nenprodukte te tjera, te lengshme si: benzol, toluol, ksilol, solven, ehite spirit.*

*Kategoria III*

*A. Gazoil (Diezel)*

*B. Vajguri ndriqes*

*C. Lende djegese per mjetet e fluturimit ajror reaktive (kerozene)*

*Ç. Lende djegese per perdorim termik civil dhe/ose industrial.*

*Kategoria IV*

*A. Vajrat*

*B. Solare*

*Kategoria V*

*A. Bitum (asfalt)*

*B. Mazut*

*Duke qene se ky operator ka ofertuar per te plotesuar kerkesat e AK produktin mazut, ne vertetimin e tij teknik dyshojme se ky produkt me kategori V.B. nuk ka as 50 meter kub apo 50 ton kapacitet e deklaruar sipas ligjit dhe VKM Nr. 970 date 2.12.2015 "Per percaktimin e procedurave dhe te kushteve per dhënien e licencave per tregtimin e naftës bruto dhe nenprodukteve të saj", e ndryshuar thuhet: a) Per licencën e llojit "A": - Per kategorinë O/A, kapaciteti i depozitave të jetë 10 000 (dhjetë mijë) m<sup>3</sup>; - Përveç kategorisë O/A, kapaciteti i depozitave të jetë 3 000 (tre mijë) m<sup>3</sup> dhe, kur kjo licencë jepet për disa kategori produktesh, depozitat duhet të jenë të ndara nga njëra-tjetra, për secilën kategori produktesh, me një kapacitet të përbashkët jo më pak se 3 000 (tre mijë) m<sup>3</sup>. Në rastin e licencimit të disa kategorive produktesh hidrokarbure, ndarja e kapaciteteve sipas produkteve hidrokarbure të jetë e pasqyruar në vërtetimin për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike, të lëshuar nga inspektorati shtetëror përgjegjës.*

*Si dhe pika 4: 4. Për çdo ndryshim të kapaciteteve apo ndryshimeve të tjera teknike/teknologjike, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, personi juridik është i detyruar të njoftojë ISHP-në, me shkrim, dhe të aplikojë në QKL për ndryshimin e licencës së tregtimit.*

*5. ISHP-ja pasqyron ndryshimin e kapaciteteve depozituese nga shoqëritë e tregtimit me shumicë, në dokumentin e vërtetimit të kontrollit të objektit për respektimin e kushteve teknike. ISHP-ja në këtë rast njofton edhe QKL-në, e cila pasqyron ndryshimet në dokumentet përkatëse të licencimit. Detyrimin për shenimin dhe pasjen e kapaciteteve për çdo produkt e gjejme edhe tek urdheri nr. 15, datë 24.8.2017 i Ministrisë të Energjitikës “Për procedurat e leshimit të vërtetimit teknik...” ku thuhet se vërtetimi teknik leshohet për miratimin e kushteve teknike, skemes dhe projektit teknologjik, pra rrjedhimisht ky subjekt është miratuar vetëm për trajtimin e 50 ton mazut dhe jo me tepër aq me pak 447 ton sa kërkon AK. Ky urdher në pikën 5 të tij kreu I thotë qartë se vërtetimi teknik përmban kategorinë e produktit dhe kapacitetin depozitues. Gjithashtu në kreun III Shqyrtimi i kërkesës pika C thuhet se bëhet verifikimi në terren i kapaciteteve depozituese të deklaruar. Pra thënë thjesht çdo kategori produkti është e mirëpërcaktuar në projekt dhe vërtetimi teknik sesa sasi do të depozitohet dhe kjo nuk është pa rendesi përderisa legjislatori e ka parashikuar me detaje, madje dhe publikohet e njoftohet në QKB për tu njohur palet e treta. AK në kriterin e saj qartësisht thekson se operatori duhet të vërtetojë kapacitetet sipas kërkesës dhe sasise referojme tek shtojca 7 Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit ku nuk ka asnjë grafik lëvrimit dhe thuhet thjesht 447.518 kg lende djegëse në këtë rast mazut pasi vetëm mazuti tregtohet aktualisht për të plotësuar këto specifikime të kërkuara nga AK si dhe TRIOS sha ka ofertuar me këtë produkt duke paraqitur dhe flete analizen përkatëse.*

*Operatori TRIOS duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kriterit:*

**2.3.2** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizë për mallin objekt prokurimi, të lëshuar nga ISHTI ose nga laborator i akredituar, e cila duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve nga data e hapjes së ofertave.*

*Kushtet e përcaktuara janë publike, operatori kishte çdo mundësi të lexonte dhe kuptonte, janë kritere që çdo operator është i detyruar të zbatojë ashtu siç kërkohen, ndryshe palet nuk kanë barazi dhe siguri juridike. Fakti që në kemi investuar në depozita shtese me të mëdha për të respektuar ligjin është dhe kosto plus.*

**2.** *Gjithashtu KVO nuk ka kryer verifikimin e ofertës anomalisht të ulët sipas Nenit 93 të LPP, subjekt mase administrative madje sipas nenit 132 LPP germa h) mosrespektimi i detyrimit për të kërkuar shpjegime për ofertën anomalisht të ulët nga operatori ekonomik sipas nenit 93, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë si dhe sipas Nenit 82, pika 4 i RPP ku për rastin e dy ofertave të sukseshme formula është Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*

*Ky është një detyrim për çdo procedurë prokurimi pavarësisht vecantise apo objektit, pasi në asnjë rast në ligjin LPP apo VKM RPP nuk gjejmë asnjë përjashtim nga ky rregull.*

*Por sa më sipër, duke gjykuar me vlerësimin dhe marzhin e fitimit të operatorit TRIOS sha, 11.31 leke për kg, dhe duke marrë parasysh se sipas VKM RPP në ditën e ofertimit të gjithë operatorët i referohen të njëjtave kushte për, bursës së ditës së shpalljes së njoftimit të procedurës dhe kursit të këtyre ditëve, rezultoi se çmimi për kg i ofruar nga ky operator është 83.526 leke për kg pa TVSH ose 100.231 leke për kg me TVSH, llogaritja e cila është e ben AK sipas edhe parashikimit të shtojcës 2 dhe KM RPP Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:*

*a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date*

*b) elementet fiskale;*

*c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.*

***PRA AK DUHET TË NXIRRTE ÇMIMIN PËR NJESI DHE TË BENTE KONTROLLIN E OFERTES ANOMALISHT TË ULET, NDRYSHE PËR CFARE DUHET ÇMIMI PËR NJESI?! VETE AK E KA NXJERR TOTALIN NË NJOFTIMIN E FITUESIT PARAPRAK,***

***PRA DI TA BEJ SHUMË MIRE LLOGARINË E OFERTES TOTALE. NË KETO KUSHTE NUK DUHET AS STUDIMI I TREGUT, AS FONDI LIMIT DHE ASGJË ME LOGJIKËN E AK.***

*Sasia e pritshme me të cilën referohemi sipas AK është 447518 kg, totali i ofertës është 37.379.388 leke pa TVSH. Fondi limit i marrë në bazë të ofertave apo kontratave të mëparshme është 54,999,962 leke pa TVSH, diferenca 32 % pashte fondin limit. Duke qenë se edhe në jemi operator në këto fushe, ky çmim dhe kjo ofertë nuk justifikon as blerjen e produktit i cili ka një çmim dhe një kosto, për më tepër ka transport deri në Krrabë ku ndodhen magazinat e AK. Vete AK duhet detyrimisht të kërkonte verifikimin e kësaj situatë pasi e ka informacionin e duhur lidhur me çmimin e këtij produkti dhe kostot perkatëse plus që është detyrim ligjor. Për më tepër, ky çmim kaq i ulët dhe fakti se vite më parë në shtator 2022 shoqëria TRIOS sha është edhe denuar për shkelje të cilesive të produkteve (dyshojmë se për lende djegëse) që mendojmë se edhe AK ka dijeni, duhet të ishin këmbana për AK për të verifikuar me tepër këto oferta jashtë çdo norme logjike tregu. E lusim KSHA të bëjë një verifikim të blerjeve dhe gjendjeve të këtij operatori në ditën e ofertimit duke e krahasuar me çmimet e prodhuesve rafinerive vendase apo greke a maqedone, pasi në këto kushte këto analize dhe ky marzh fitimi nuk justifikon dot as blerjen. Kujtojmë AK se shitja me humbje është e ndaluar dhe nga ligji për TVSH.*

*Madje AK dhe KPP të marrin dhe informacion nga tatimet dhe dogana për këto produkt lidhur me vlerat e blerjes dhe shitjes së tij qoftë dhe për operatorin TRIOS në vecanti për të konfirmuar se ku dhe si e gjen ky operator këto produkt me këto çmime dhe a ka gjendje apo jo që në fakt edhe sipas pikës më sipër nuk mund të mbajë sasi më tepër se aq sa lejon vertetimi teknik i tij. Bejmë me dije se blerja reale e produktit mazut është me çmim më të lartë se bursa platts dhe*

*premio nuk eshte 30 \$ per ton ne rafinerite prodhuese sic e publikon dogana ne bursen e saj, por eshte me teper. Per sa me siper, kerkojme KSHA dhe KPP verifikimin e pretendimeve tona dhe zbatimin e ligjit per verifikimin e ofertes anomalisht te ulet subjekt edhe mase administrative per te cilen ne mungese te zbatimit do te njoftohet dhe APP per procedim te metejshem. Per referim cmimet e rafinerise SHELL CORAL ne Greqi per produktin mazut fuel oil ne ditën e hapjes se ofertave dhe shpalljes se njoftimit ne sistem, kesaj i duhet shtuar dhe kosto transporti.”*

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1025/1 Prot., datë 03.04.2026.

II.6. Në datën 10.04.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.1025/2 prot., Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr. 5847/12 prot., datë 10.04.2026. Referuar këtij vendimi rezulton se autoriteti kontraktor ka refuzuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimes konkretisht si më poshtë vijon:

*“[...] KSHA u mblodh sot më datë 09.04.2026 për të shqyrtuar ankimin e operatorit ekonomik.*

#### ***Pretendimi I :***

*Ankimojme vleresimin e KVO pasi operatori TRIOS sha nuk ploteson kriterin:*

*Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon depozita në pronësi ose me qira, faktuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale, akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj) duke vërtetuar kapacitetet depozituese dhe rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për depozitat Vërtetim teknik nga ISHTI ose nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), leje mjedisore sipas legjislacionit në fuqi të lëshuar nga QKL, Akt Teknik të lëshuar nga PMNZH dhe policë sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri.*

*Kjo pasi dyshojme se nuk ka kapacitete prej 447.518 kg ose 447,5 ton mazut, duke mos vërtetuar kapacitetet depozituese dhe rezervat e operatorit ekonomik e duke mos garantuar vazhdimësinë e furnizim sic kerkon kriteri. Per kete dokumenti zyrtar ku shenohen kapacitetet eshte vërtetimi teknik i lëshuar nga OMVK perkatese pasi sipas ligjit Nr.8450, date 24.2.1999 “Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, te gazit dhe nenprodukteve te tyre”, i ndryshuar neni 10 mazuti eshte kategori me vete Kategoria V A. Bitum (asfalt), B. Mazut.*

*Neni 10*

*Ne kuptim te këtij ligji, nafta, gazi natyror dhe nënproduktet e tyre klasifikohen ne kategori, si vijon:*

*Kategoria O*

*A. Nafta bruto*

*B. Gazi natyror*

### *Kategoria I*

*A. Gazi i lëngshëm*

### *Kategoria II*

*A. Benzine automjetesh*

*B. Benzine mjetesh te fluturimit ajror*

*C. Nënprodukte te tjera, te lëngshme si: benzol, toluol, ksilol, solven, ëhite spirit.*

### *Kategoria III*

*A. Gazoil (Diezel)*

*B. Vajguri ndriçues*

*C. Lende djegëse për mjetet e fluturimit ajror reaktive (kerozene)*

*Ç. Lëndë djegëse për përdorim termik civil dhe/ose industrial.*

### *Kategoria IV*

*A. Vajrat*

*B. Solare*

### *Kategoria V*

*A. Bitum (asfalt)*

*B. Mazut*

*Duke qene se ky operator ka ofertuar per te plotesuar kerkesat e AK produktin mazut, ne vertetimin e tij teknik dyshojme se ky produkt me kategori V.B. nuk ka as 50 meter kub apo 50 ton kapacitet e deklaruar sipas ligjit dhe VKM Nr. 970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, e ndryshuar thuhet: a) Për licencën e llojit “A”: - Për kategorinë 0/A, kapaciteti i depozitave të jetë 10 000 (dhjetë mijë) m<sup>3</sup>; - Përveç kategorisë 0/A, kapaciteti i depozitave të jetë 3 000 (tre mijë) m<sup>3</sup> dhe, kur kjo licencë jepet për disa kategori produktesh, depozitat duhet të jenë të ndara nga njëra-tjetra, për secilën kategori produktesh, me një kapacitet të përbashkët jo më pak se 3 000 (tre mijë) m<sup>3</sup>. Në rastin e licencimit të disa kategorive produktesh hidrokarbure, ndarja e kapaciteteve sipas produkteve hidrokarbure të jetë e pasqyruar në vërtetimin për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike, të lëshuar nga inspektorati shtetëror përgjegjës.*

*Si dhe pika 4: 4. Për çdo ndryshim të kapaciteteve apo ndryshimeve të tjera teknike/teknologjike, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, personi juridik është i detyruar të njoftojë ISHP-në, me shkrim, dhe të aplikojë në QKL për ndryshimin e licencës së tregtimit.*

*5. ISHP-ja pasqyron ndryshimin e kapaciteteve depozituese nga shoqëritë e tregtimit me shumicë, në dokumentin e vërtetimit të kontrollit të objektit për respektimin e kushteve teknike. ISHP-ja në këtë rast njofton edhe QKL-në, e cila pasqyron ndryshimet në dokumentet përkatëse të licencimit. Detyrimin për shenimin dhe pasjen e kapaciteteve për çdo produkt e gjejmë edhe tek urdheri nr. 15, datë 24.8.2017 i Ministrisë të Energjitikës “Për procedurat e leshimit të vërtetimit teknik...” ku thuhet se vërtetimi teknik leshohet për miratimin e kushteve teknike, skemes dhe projektit teknologjik, pra rrjedhimisht ky subjekt është miratuar vetëm për trajtimin e 50 ton mazut dhe jo më tepër aq më pak 447 ton sa kerkon AK. Ky urdher në pikën 5 të tij kreu I thote qarte se vërtetimi teknik përmban kategorinë e produktit dhe kapacitetin depozitues. Gjithashtu në kreun III*

Shqyrtimi i kërkeses pika C thuhet se behet verifikimi ne terren i kapaciteve depozituese te deklaruar. Pra thene thjesht cdo kategori produkti eshte e mirepercaktuar ne projekt dhe vertetim teknik sesa sasi do te depozitohet dhe kjo nuk eshte pa rendesi perderisa legjislatori e ka parashikuar me detaje, madje dhe publikohet e njoftohet ne QKB per tu njohur palet e treta. AK ne kriterin e saj qartesisht thekson se operatori duhet te vertetoje kapacitetet sipas kërkeses dhe sasise referojme tek shtojca 7 Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit ku nuk ka asnje grafik levrimit dhe thuhet thjesht 447.518 kg lende djegese ne kete rast mazut pasi vetem mazuti tregtohet aktualisht per te plotesuar keto specifikime te kerkuara nga AK si dhe TRIOS sha ka ofertuar me kete produkt duke paraqitur dhe flete analizen perkatese.

Operatori TRIOS duhet te ishte skualifikuar per mosplotesim te kriterit

I.I Lidhur me pretendimin e I, KSHA argumenton si me poshte vijon:

Në dokumentet e tenderit është parashikuar:

“Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon depozita në pronësi ose me qira, të faktuara me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil [...] duke vërtetuar kapacitetet depozituese dhe rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për depozitat Vërtetim teknik nga ISHTI ose OMVK, leje mjedisore, Akt Teknik nga PMNZH dhe polici sigurimi...”

Lidhur me plotesimin e ketij kriteri OE TRIOS sha i shpallur i suksesshem ka dorezuar ne autoritet sipas kërkeses se KVO-se dokumentacionin si më poshte vijon :

- Çertifikatë për vërtetim pronësie nr. 1695178, për pasurinë e paluajtshme ndërtesë nr. 3321, Nr Pasurie 343/16 N.D, me sipërfaqe 1675 m<sup>2</sup>, bashkëlidhur kartela e pasurisë, harta treguese dhe foto të depozitave.
- Ekstraktin Historik Tregëtar të datës 26.01.2026, ku në rubrikën vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit provohet dhe disponueshmëria e adresës “Vaçar SHARRE Sharre, Zona Kadastrale 3321, Nr Pasurie 343/16”, Tiranë.
- Licencë me kategorine VI.1.A me veprimtari: Tregëtim me shumice i Solar kategoria IV/B, Bitum kategoria V/A, Mazut kategoria V/B, me vend të kryerjes së veprimtarisë në adresen “Vaçar SHARRE Sharre, Zona Kadastrale 3321, Nr Pasurie 343/16”, Tirane;
- Leje Mjedisore me kategori I.1.B me veprimtari: Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj...etj, me adrese “Vaçar SHARRE Sharre, Zona Kadastrale 3321, Nr Pasurie 343/16”, Tirane;
- Vërtetim Teknik nr. VT 3823, datë 03.02.2026, lëshuar nga Organi i Miratuar “Seiss Aproval Albania” shpk, OMVK 011, me emërtim të pajisjeve: “Depozitim & Tregëtim me shumicë i nënprodukteve të naftës”, kategoria V/B “Mazut” e{J, kapaciteti 50 m<sup>2</sup>, vlefshmëria 03.02.2027;
- Çertifikatë Për Sigurinë nga Zjarri, datë 15.09.2023, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH;
- Policë Sigurimi nr. Serial 251202922, datë 20.05.2025, lëshuar nga ALBSIG sh.a.

Kriteri i vendosur nga Autoriteti Kontraktor duhet kuptuar në funksion të qëllimit të tij thelbësor, i cili nuk është imponimi i një barre formale mbi operatorët ekonomikë, por mundësimi i një

vlerësimi real dhe të arsyeshëm të kapaciteteve të tyre teknike për të përmbushur kontratën. Në këtë kuadër, kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit mbi ekzistencën dhe ligjshmërinë e depozitave nuk synon të provojë zotërimin aktual të gjithë sasisë së mallit në momentin e ofertimit apo disponimin e një kapaciteti depozitues të barabartë me sasinë totale të kontratës, por të krijojë bindjen se operatori ekonomik zotëron infrastrukturën e nevojshme dhe kapacitetin objektiv për të garantuar furnizim të pandërprerë gjatë gjithë periudhës së zbatimit të saj. Për rrjedhojë, kriteri shërben si një instrument verifikues për Autoritetin Kontraktor, në mënyrë që ky i fundit të njohë dhe vlerësojë në mënyrë korikrete aftësinë teknike dhe organizative të operatorëve ekonomikë, në raport me natyrën dinamike të furnizimit dhe karakterin jo të njëhershëm të tij. Cdo interpretim që e shndërron këtë kriter në një detyrim për mbajtjen fizike të të gjithë sasisë ose për sigurimin e një kapaciteti depozitues të barasvlershëm me të do të tejkalonte funksionin e tij real, duke e deformuar atë nga një mjet vlerësimi në një kërkesë kufizuese dhe jorealiste, e shkëputur nga logjika ekonomike e kontratës dhe nga vetë natyra e furnizimit të parashikuar.

Edhe vetë operatori ekonomik ankimes “Resuli” sh.a. pranon shprehimisht se objekti i prokurimit lidhet me një mall burse dhe se sasia e parashikuar nga Autoriteti Kontraktor ka karakter thjesht orientues, pa qenë në asnjë moment e kërkuar që ajo të disponohet fizikisht në kohën e ofertimit. Ky pranim përforcon në mënyrë të drejtpërdrejtë arsyetimin mbi të cilin mbështetet vendimmarrja e KVO-së, pasi natyra e mallrave të bursës, si mazuti, karakterizohet nga luhajtje të vazhdueshme të çmimit dhe disponueshmërisë në kohë, çka e bën të paarsyeshme dhe ekonomikisht të pajustificuar kërkesën për zotërimin paraprak të një sasive të plotë. Në të njëjtën linjë, sasia prej 447,518 kg përfaqëson një parashikim orientues për një periudhë dyvjeçare dhe jo një detyrim për furnizim të menjëhershëm dhe të njëhershëm. Për rrjedhojë, kërkesa e Autoritetit Kontraktor duhet interpretuar në funksion të qëllimit të saj real, që është provimi i kapacitetit real dhe të licencuar të operatorit ekonomik për të garantuar furnizim të vazhdueshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, dhe jo si një detyrim për mbajtjen në depo të të gjithë sasisë së parashikuar.

Pretendimi i mësipërm nuk qëndron.

#### **KONKLUZION**

KSHA nuk ka gjetur mangësi në dokumentacionin kërkuar pasi OE TRIOS sha ka paraqitur vërtetimin teknik, lejen mjedisore, aktin teknik, policën e sigurimit dhe dokumentet e pronësisë. Për sa kohë dokumentacioni është në përputhje me kërkesat formale dhe materiale të dokumenteve të tenderit, KSHA nuk ka bazë ligjore të skualifikojë operatorin me interpretim kufizues shtesë. Ndonese te shtojca 7 nuk ka grafik të detajuar levrimiti, kjo tregon se AK nuk e ka konceptuar furnizimin si një ngarkesë të vetme që kërkon depozitimin e gjithë sasisë, por si furnizim të vazhdueshëm sipas nevojave. Në mungesë të një kërkesë specifike për disponimin e një kapaciteti minimal depozitues të barabartë me gjithë sasinë, nuk mund t'i kërkohej operatorit diçka që nuk është kërkuar në mënyrë eksplicite.

Si përfundim duke u bazuar në kriterin e vendosur nga AK, natyrën e produktit (mall burse) dhe të kontratës (furnizim afatgjatë me sasi orientuese), funksionin real të vërtetimit teknik dhe të kapacitetit depozitues sipas ligjit sektorial, parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosndryshimit të kriterëve pas hapjes së ofertave;

*Rezultoni se Operatori TRIOS sha, për sa kohë ka paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara (vërtetim teknik, leje mjedisore, akt teknik, polici sigurimi, prova të pronësisë/qirasë), nuk mund t'i mohohet kualifikimi përmes interpretimit të zgjeruar të ligjit, i cili nuk kërkon që kapaciteti depozitues të jetë i njëjtë me sasinë totale të furnizimeve në kontratë dhe për këto arsye skualifikimi, do të ishte në kundërshtim si me tekstin e kritereve ashtu edhe me parimet e ligjit për prokurimet publike.*

*Kriteri i vendosur nga Autoriteti Kontraktor, që kërkon vërtetimin e kapaciteteve depozituese dhe rezervave për garantimin e vazhdimësisë së furnizimit, duhet interpretuar në funksion të qëllimit të tij real, që është verifikimi i kapacitetit teknik të operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën në mënyrë të vazhdueshme dhe jo imponimi i një detyrimi për disponimin fizik të të gjithë sasisë në momentin e ofertimit apo për zotërimin e një kapaciteti depozitues të barabartë me sasinë totale të kontratës. Në këtë kuadër, për sa kohë operatori ekonomik ka provuar ekzistencën e depozitave të licencuara, kapacitetin e tyre teknik dhe bazën ligjore të përdorimit, organi vlerësues është i legjitimuar të konkludojë se ai ka aftësinë objektive për të siguruar furnizim të vazhdueshëm, në përputhje me natyrën e kontratës si furnizim afatgjatë dhe me natyrën e produktit si mall burse, i cili karakterizohet nga furnizime të njëpasnjëshme dhe jo nga mbajtja në stok e të gjithë sasisë. Pretendimi se kapaciteti depozitues duhet të jetë i barabartë me sasinë prej 447,518 kg apo se vërtetimi teknik që pasqyron një kapacitet prej 50 tonësh përbën kufizim për furnizimin total është i pabazuar, pasi kjo sasi është thjesht orientuese për një periudhë dyvjeçare dhe kapaciteti teknik i depozitës lidhet me ngarkesën maksimale në një moment të caktuar dhe jo me volumin e përgjithshëm të furnizimeve në kohë. Për më tepër, kuadri ligjor sektorial rregullon kushtet e licencimit dhe sigurisë, pa vendosur asnjë kufizim që lidh kapacitetin depozitues momental me sasinë totale që mund të furnizohet gjatë kontratës. Për rrjedhojë, për sa kohë dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit, skualifikimi mbi bazën e një interpretimi të zgjeruar dhe të pashprehur të këtyre kërkesave do të ishte i pajustificuar dhe në kundërshtim me logjikën e kriterit dhe me mënyrën normale të funksionimit të tregut.*

*Pretendimi i mësipërm nuk qëndron.*

### **II Lidhur me pretendimin 2.3.2**

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizë për mallin objekt prokurimi, të lëshuar nga ISHTI ose nga laborator i akredituar, e cila duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve nga data e hapjes së ofertave. Kushtet e percaktuara janë publike, operatori kishte cdo mundësi të lexonte dhe kuptonte, janë kritere që cdo operator është i detyruar të zbatoj ashtu siç kerkohen, ndryshe palet nuk kanë barazi dhe siguri juridike. Fakti që ne kemi investuar në depozita shtese me të mëdha për të respektuar ligjin është dhe kosto plus.*

*II.Lidhur me këto pretendim KSHA argumenton se pretendimi i operatorit ekonomik, sipas të cilit investimet më të mëdha në kapacitete depozituese duhet të përkthehen në avantazh konkurrues apo të çojnë në skualifikimin e operatorëve të tjerë, është i pabazuar dhe nuk ndikon në ligjshmërinë e vendimmarrjes së KVO-së, pasi procedura e prokurimit mbështetet në përmbushjen e kritereve të*

*shpallura njësoj për të gjithë dhe jo në nivelin e investimeve individuale të secilit operator. Në momentin që Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar qartë dokumentacionin dhe kërkesat që duhet të plotësohen, dhe operatorët ekonomikë kanë paraqitur në mënyrë të rregullt dokumentet përkatëse, përfshirë fletë analizën dhe dokumentacionin teknik e ligjor për depozitat, KVO ka për detyrë të verifikojë vetëm përmbushjen e këtyre kritereve dhe nuk mund të vendosë standarde shtesë apo të krijojë avantazhe të pashkruara. Fakti që një operator ka realizuar investime më të mëdha përbën një zgjedhje të tij dhe nuk mund të shndërrohet në kriter përjashtues për operatorët e tjerë që përmbushin kërkesat minimale, pasi një interpretim i tillë do të sillte në mënyrë të tërthortë vendosjen e një kriteri të ri, të paparashikuar në dokumentet e tenderit, duke cenuar barazinë e trajtimit dhe konkurrencën efektive. Për rrjedhojë, për sa kohë një operator ekonomik ka provuar me dokumentacion të vlefshëm përmbushjen e të gjitha kërkesave të përcaktuara, ai nuk mund të skualifikohet mbi bazën e krahasimit me nivelin e investimit të një operatori tjetër, pasi ligjshmëria e vlerësimit lidhet me përmbushjen e kritereve dhe jo me madhësinë e kapaciteteve përtej atyre që janë kërkuar.*

### **KONKLUZION**

*Kushtet e pjesëmarrjes në procedurë, përfshirë detyrimin për paraqitjen e fletë analizës së mallrave brenda afatit 3-mujor dhe dokumentacionin për depozitat (vërtetim teknik, leje mjedisore, akt teknik, polici sigurimi, dokumente pronësie/qiraje), janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të njëjtë për të gjithë operatorit ekonomikë. Barazia dhe siguria juridike në prokurim nuk nënkuptojnë favorizimin e operatorëve që, sipas strategjisë së tyre biznesore, kanë realizuar investime më të mëdha se minimumi i kërkuar, por trajtimin e barabartë të të gjithë pjesëmarrësve që përmbushin kriteret e shpallura.*

*Në momentin që një operator ekonomik vërteton, me dokumentet e kërkuara, se disponon depozita të licencuara dhe të miratuara teknikisht për kategorinë përkatëse të produktit, si dhe paraqet fletë analizë të vlefshme për mallin objekt prokurimi, ai konsiderohet se përmbush kriterin teknik, pavarësisht nëse depozitat e tij janë më të mëdha apo më të vogla se ato të një operatori tjetër konkurrent. Vendosja, pas hapjes së ofertave, e një avantazhi për operatorët që kanë bërë investime më të mëdha do të përbënte, në vetvete, ndryshim të padrejtë të kritereve të përcaktuara paraprakisht dhe cenim të parimit të trajtimit të barabartë.*

*Për rrjedhojë, fakti që një operator ka realizuar investime shtesë në depozita me kapacitet më të madh nuk krijon bazë ligjore për skualifikimin e operatorit tjetër, i cili ka përmbushur plotësisht të gjitha kushtet e dokumentuara në dokumentet e tenderit dhe në legjislacionin në fuqi.*

*Pretendimi i mësipërm nuk qëndron.*

### **Pretendimi III**

*KVO nuk ka kryer verifikimin e ofertes anomalisht të ulët sipas Nenit 93 të LPP, subjekt mase administrative madje sipas nenit 132 LPP germa h) mosrespektimi i detyrimit për të kërkuar shpjegime për ofertën anomalisht të ulët nga operatori ekonomik sipas nenit 93, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë si dhe sipas Nenit 82, pika 4 i RPP ku për rastin e dy ofertave të suksesshme formula është Pas*

korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur; Ky është një detyrim për çdo procedurë prokurimi pavarësisht vecantise apo objektit, pasi në asnjë nen të ligjit LPP apo VKM RPP nuk gjejmë asnjë përjashtim nga ky rregull.

Për sa me sipër, duke gjykuar me vlerësimin dhe marzhin e fitimit të operatorit TRIOS sha, 11.31 leke për kg, dhe duke marrë parasysh se sipas VKM RPP në ditën e ofertimit të gjithë operatorët i referohen të njetave kushte pra, bursës së ditës së shpalljes së njoftimit të procedurës dhe kursit e këte dite, rezultojnë se çmimi për kg i ofruar nga ky operator është 83.526 leke për kg pa tvsh ose 100.231 leke për kg me tvsh, llogaritja e ben AK sipas edhe parashikimit të shtojcës 2 dhe KM RPP Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

**PRA AK DUHET TE NXIRRTE CMIMIN PER NJESI DHE TE BENTE KONTROLLIN E OFERTES ANOMALISHT TE ULET, NDRYSHE PER CFARE DUHET CMIMI PER NJESI?! VETE AK E KA NXJERR TOTALIN NE NJOFTIMIN E FITUESIT PARAPRAK, PRA DI TA BEJ SHUME MIRE LLOGARINE E OFERTES TOTALE. NE KETO KUSHTE NUK DUHET AS STUDIMI I TREGUT, AS FONDI LIMIT DHE ASGJE ME LOGJIKEN E AK.**

Sasia e pritshme me të cilën referohemi sipas AK është 447518 kg, totali i ofertës është 37.379.388 leke pa tvsh. Fondi limit i marrë në bazë të ofertave apo kontratave të mëparshme është 54,999,962 leke pa tvsh, diferenca 32 % poshtë fondit limit. Duke qenë se edhe në jemi operator në këte fushë, ky çmim dhe kjo ofertë nuk justifikon as blerjen e produktit i cili ka një çmim dhe një kosto, për më tepër ka transport deri në Krrabë ku ndodhen magazinat e AK. Vete AK duhet detyrimisht të kërkonte verifikimin e kësaj situatë pasi e ka informacionin e duhur lidhur me çmimin e këtij produkti dhe kostot perkatëse plus që është detyrim ligjor. Për më tepër, ky çmim kaq i ulët dhe fakti se vite më parë në shtator 2022 shoqëria TRIOS sha është denuar për shkelje të cilesisë së produkteve (dyshojmë se për lende djegëse) që mendojmë se edhe AK ka dijeni, duhet të ishin këmbana për AK për të verifikuar me tepër këte ofertë jashtë çdo norme logjike tregu. E lusim KSHA të bëjë një verifikim të blerjeve dhe gjendjeve të këtij operatori në ditën e ofertimit duke e krahasuar me çmimet e prodhuesve rafinerive vendase apo greke a maqedone, pasi në e kemi bërë këte analizë dhe ky marzh fitimi nuk justifikon dot as blerjen. Kujtojmë AK se shitja me humbje është e ndaluar dhe nga ligji për TVSH.

*Madje AK dhe KPP te marrin dhe informacion nga tatimet dhe dogana per kete produkt lidhur me vlerat e blerjes dhe shitjes se tij qofte dhe per operatorin TRIOS ne vecanti per te konfirmuar se ku dhe si e gjen ky operator kete produkt me keto cmime dhe a ka gjendje apo jo qe ne fakt edhe sipas pikes me siper nuk mund te mbaj sasi me teper se aq sa lejon vertetimi teknik i tij. Bejme me dije se blerja reale e produktit mazut eshte me cmim me te larte se bursa platts dhe premio nuk eshte 30 \$ per ton ne rafinerite prodhuese sic e publikon dogana ne bursen e saj, por eshte me teper. Per sa me siper, kerkojme KSHA dhe KPP verifikimin e pretendimeve tona dhe zbatimin e ligjit per verifikimin e ofertes anomalisht te ulet subjekt edhe mase administrative per te cilen ne mungese te zbatimit do te njoftohet dhe APP per procedim te metejshem. Per referim cmimet e rafinerise SHELL CORAL ne Greqi per produktin mazut fuel oil ne ditën e hapjes se ofertave dhe shpalljes se njoftimit ne sistem, kesaj i duhet shtuar dhe kosto transporti.*

*III.III Lidhur me pretendimin e mesiperem KSHA argumenton si me poshte vijon:*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vepruar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe me natyrën specifike të procedurës së prokurimit, pasi në rastin e furnizimit me mallra burse, si mazuti, struktura e çmimit nuk lihet në vullnetin e lirë të operatorëve ekonomikë, por është e standardizuar dhe e përcaktuar paraprakisht nga mekanizmi ligjor përkatës. Në këtë lloj procedure, çmimi i kontratës nuk përbën një ofertë të lirë për njësi, por rezulton nga një formulë e detyrueshme që përfshin çmimin e bursës dhe elementët fiskalë, të cilët janë objektivë, të njëjtë dhe të pandryshueshëm për të gjithë operatorët, duke bërë që elementi i vetëm konkumies të mbetet norma e fitimit e deklaruar prej tyre. Për rrjedhojë, vlerësimi i kryer mbi normën e fitimit përbën në vetvete vlerësimin e çmimit të ofertës, ndërsa çmimi për njësi është thjesht një derivat teknik i kësaj norme, i përlllogaritur sipas formulës ligjore dhe jo një komponent i pavarur që mund të vlerësohet veçmas.*

*Në këtë kontekst, edhe analiza e ofertës anomalisht të ulët duhet të interpretohet në mënyrë funksionale dhe në përputhje me natyrën e këtij mekanizmi çmimor. Ndryshe nga procedurat klasike, ku operatorët kanë liri të plotë në formimin e çmimit dhe një ulje e ndjeshme mund të sinjalizojë rrezik për mosrealizim të kontratës, në rastin e mallrave të bursës një diferencë e konsiderueshme nga fondi limit nuk buron nga një çmim i ulur, por nga një normë fitimi më e ulët e pranuar nga operatori mbi një bazë çmimi të fiksuar nga tregu dhe legjislacioni fiskal. Për sa kohë kjo normë fitimi rezulton pozitive dhe nuk provon një situatë të qartë të shitjes nën kosto, ajo nuk cenon realizueshmërinë ekonomike të kontratës dhe nuk përbën, në vetvete, shkak për skualifikim.*

*Për më tepër, edhe nëse do të konsiderohej se duhej ndjekur formalisht procedura për kërkimin e shpjegimeve mbi ofertën anomalisht të ulët, mungesa e një hapi të tillë nuk prek vlefshmërinë e procedurës apo të vendimit të KVO-së, pasi legjislacioni parashikon pasoja administrative për autoritetin kontraktor dhe jo pavlefshmëri automatike të vendimmarrjes. Në kushtet kur çmimi është formuar në mënyrë të detyrueshme sipas formulës ligjore për mallrat e bursës, norma e fitimit e ofertës fituese është pozitive dhe e krahasueshme me praktikën e tregut, si dhe vlerësimi është kryer mbi të vetmin element konkurrues në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët,*

rezulton se analiza e KVO-së ka qenë materiale, reale dhe e mjaftueshme për të garantuar ligjshmërinë e procedurës.

Në procedurën në fjalë, objekt prokurimi është një mall burse (mazut), për të cilin, në zbatim të nenit 45/2.1 të VKM nr. 285/2021 dhe Shtojcës 2 të dokumenteve standarde, çmimi i kontratës nuk ofrohet lirisht si çmim për njësi, por përlllogaritet nga autoriteti kontraktor mbi bazën e çmimit të bursës në datën e publikimit të njoftimit, elementëve fiskalë dhe normës së fitimit të shprehur në vlerë absolute, të deklaruar nga operatori ekonomik. Si rrjedhim, elementi i vetëm konkurrues midis operatorëve është norma e fitimit, ndërsa komponentët e tjerë të çmimit janë të unifikuar dhe të njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit.

Për rrjedhojë, pretendimi se nuk është kryer një vlerësim i drejtë i çmimit apo se oferta duhet të konsiderohet anomalisht e ulët për shkak të diferencës me fondin limit nuk qëndron, pasi në këtë lloj prokurimi “çmimi” identifikohet me normën e fitimit dhe kontrolli i arsyeshmërisë së saj zëvendëson analizën klasike të kostove. Në këto kushte, përzgjedhja e ofertës me normën më të ulët të fitimit si oferta ekonomikisht më e favorshme është rezultat i një vlerësimi të kryer në përputhje me ligjin, me natyrën e tregut dhe me parimet e konkurrencës efektive, duke mos u cenuar nga pretendimet për moszbatim formal të mekanizmit të ofertës anomalisht të ulët.

#### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR MBI ANKESËN**

Për të konkluduar, në bazë të dokumentave dhe fakteve të sipërcituara dhe në zbatim të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 82 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, njëzëri,

#### **VENDOS:**

Rrezimin plotësisht të ankesës me Nr elektronik ankese A/2026/6476 dhe me Nr.Prot 1025/1 prot Datë 03.04.2026 e Operatorit Ekonomike “RESULI - ER” SHA, me NUIS L12510413V.”

II.7. Në datën 14.04.2026 është protokolluar në KPP me nr. 1025/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.5947/13 prot., datë 10.04.2026 me objekt: “Kthim përgjigje”, bashkëlidhur vendimi nr. 5947/12/ prot., datë 10.04.2026 i KSHA-së në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Resuli-Er” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8.Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se: “**I. Ankimojme vleresimin e KVO pasi operatori TRIOS sha nuk ploteson kriterin:**

*Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon depozita në pronësi ose me qira, faktuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale, akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj) duke vërtetuar kapacitetet depozituese dhe rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për depozitat Vërtetim teknik nga ISHTI ose nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), leje mjedisore sipas legjislacionit në fuqi të lëshuar nga QKL, Akt Teknik të lëshuar nga PMNZH dhe policë sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri.*

*Kjo pasi dyshojme se nuk ka kapacitete prej 447.518 kg ose 447,5 ton mazut, duke mos vërtetuar kapacitetet depozituese dhe rezervat e operatorit ekonomik e duke mos garantuar vazhdimësinë e furnizim sic kërkon kriteri. Per kete dokumenti zyrtar ku shenohen kapacitetet eshte vërtetimi teknik i lëshuar nga OMVK perkatese pasi sipas ligjit Nr.8450, date 24.2.1999 “Per perpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftes, te gazit dhe nenprodukteve te tyre”, i ndryshuar neni 10 mazuti eshte kategori me vete Kategoria V A. Bitum (asfalt), B. Mazut.*

*Neni 10*

*Ne kuptim te këtij ligji, nafta, gazi natyror dhe nënproduktet e tyre klasifikohen ne kategori, si vijon:*

*Kategoria O*

*A. Nafta bruto*

*B. Gazi natyror*

*Kategoria I*

*A. Gazi i lëngshëm*

*Kategoria II*

*A. Benzine automjetesh*

*B. Benzine mjetesh te fluturimit ajror*

*C. Nënprodukte te tjera, te lëngshme si: benzol, toluol, ksilol, solven, ëhite spirit.*

*Kategoria III*

*A. Gazoil (Diezel)*

*B. Vajguri ndriçues*

*C. Lende djegëse për mjetet e fluturimit ajror reaktive (kerozene)*

*Ç. Lëndë djegëse për përdorim termik civil dhe/ose industrial.*

*Kategoria IV*

*A. Vajrat*

*B. Solare*

*Kategoria V*

*A. Bitum (asfalt)*

## *B. Mazut*

*Duke qene se ky operator ka ofertuar per te plotesuar kerkesat e AK produktin mazut, ne vertetimin e tij teknik dyshojme se ky produkt me kategori V.B. nuk ka as 50 meter kub apo 50 ton kapacitet e deklaruar sipas ligjit dhe VKM Nr. 970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, e ndryshuar thuhet: a) Për licencën e llojit “A”: - Për kategorinë 0/A, kapaciteti i depozitave të jetë 10 000 (dhjetë mijë) m<sup>3</sup>; - Përveç kategorisë 0/A, kapaciteti i depozitave të jetë 3 000 (tre mijë) m<sup>3</sup> dhe, kur kjo licencë jepet për disa kategori produktesh, depozitat duhet të jenë të ndara nga njëra-tjetra, për secilën kategori produktesh, me një kapacitet të përbashkët jo më pak se 3 000 (tre mijë) m<sup>3</sup>. Në rastin e licencimit të disa kategorive produktesh hidrokarbure, ndarja e kapaciteteve sipas produkteve hidrokarbure të jetë e pasqyruar në vërtetimin për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike, të lëshuar nga inspektorati shtetëror përgjegjës.*

*Si dhe pika 4: 4. Për çdo ndryshim të kapaciteteve apo ndryshimeve të tjera teknike/teknologjike, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, personi juridik është i detyruar të njoftojë ISHP-në, me shkrim, dhe të aplikojë në QKL për ndryshimin e licencës së tregtimit.*

*5. ISHP-ja pasqyron ndryshimin e kapaciteteve depozituese nga shoqëritë e tregtimit me shumicë, në dokumentin e vërtetimit të kontrollit të objektit për respektimin e kushteve teknike. ISHP-ja në këtë rast njofton edhe QKL-në, e cila pasqyron ndryshimet në dokumentet përkatëse të licencimit. Detyrimin për shenimin dhe pasjen e kapaciteteve për çdo produkt e gjejmë edhe tek urdheri nr. 15, datë 24.8.2017 i Ministrisë të Energjitikës “Për procedurat e leshimit të vërtetimit teknik...” ku thuhet se vërtetimi teknik leshohet për miratimin e kushteve teknike, skemes dhe projektit teknologjik, pra rrjedhimisht ky subjekt është miratuar vetëm për trajtimin e 50 ton mazut dhe jo me teper aq me pak 447 ton sa kërkon AK. Ky urdher në pikën 5 të tij kreu I thotë qartë se vërtetimi teknik përmban kategorinë e produktit dhe kapacitetin depozitues. Gjithashtu në kreun III Shqyrtimi i kërkesës pika C thuhet se bëhet verifikimi në terren i kapaciteteve depozituese të deklaruara. Pra thënë thjesht çdo kategori produkti është mirapërcaktuar në projekt dhe vërtetimi teknik sesa sasi do të depozitohet dhe kjo nuk është pa rëndësi përderisa legjislatori e ka parashikuar me detaje, madje dhe publikohet e njoftohet në QKB për tu njohur palet e treta. AK në kriterin e saj qartësisht thekson se operatori duhet të vërtetojë kapacitetet sipas kërkesës dhe sasisë referojmë tek shtojca 7 Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit ku nuk ka asnjë grafik lëvrimit dhe thuhet thjesht 447.518 kg lende djegëse në këtë rast mazut pasi vetëm mazuti tregtohet aktualisht për të plotësuar këto specifikime të kërkuara nga AK si dhe TRIOS shpesh ka ofertuar me këto produkt duke paraqitur dhe flete analizen përkatëse.*

*Operatori TRIOS duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kriterit:*

**2.3.2** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizë për mallin objekt prokurimi, të lëshuar nga ISHTI ose nga laborator i akredituar, e cila duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve nga data e hapjes së ofertave.*

*Kushtet e përcaktuara janë publike, operatori kishte çdo mundësi të lexonte dhe kuptonte, janë kritere që çdo operator është i detyruar të zbatojë ashtu siç kërkohen, ndryshe palet nuk kanë barazi*

dhe siguri juridike. Fakti që ne kemi investuar në depozitë shtese me të mëdha për të respektuar ligjin është dhe kosto plus”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.2, 2.3.3 dhe 2.3.4 në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizë për mallin objekt prokurimi, të lëshuar nga ISHTI ose nga laborator i akredituar, e cila duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve nga data e hapjes së ofertave.*

2.3.3 *Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon depozitë në pronësi ose me qira, faktuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale, akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e OKB, etj) duke vërtetuar kapacitetet depozituese dhe rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për depozitat Vërtetim teknik nga ISHTI ose nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), leje mjedisore sipas legjislacionit në fuqi të lëshuar nga OKL, Akt Teknik të lëshuar nga PMNZH dhe policë sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri.*

2.3.4 *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim, nëpërmjet së cilës angazhohet që për çdo furnizim të mallit objekt prokurimi sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, të paraqesë fletë analize të kryer rishtazi, të lëshuar nga një laborator i akredituar/autorizuar, e cila vërteton përputhshmërinë e mallit me kërkesat si dhe me standardet teknike përkatëse të aplikueshme.*

*Mosparaqitja e fletës së analizës ose mosrespektimi i kërkesave ligjore dhe teknike përbën shkak për refuzimin e furnizimit .*

III.1.2. Në shtojcën 7 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” është parashikuar si vijon:

### **Shtojca 7.**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

## **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e pritshme: 447,518 kg**

**Afatet e lëvrimit:** Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas kërkesës, në bazë të marrëveshjes kuadër 24 mujore.

<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma</b>	<b>Destinacioni</b>
1	Lëndë djegëse për përdorim termik, civil dhe industrial, me përmbajtje squfuri jo më shumë se 1% ndaj masës	447,518 kg	Në afërsi të tunelit të Kërrabës, përgjatë autostradës Tiranë-Elbasan, Njësia Administrative Krrabë, Tiranë

III.1.3. Gjithashtu në Njoftimin e Kontratës, Seksioni II., pika 2.6 është parashikuar:

**2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:**

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes:

Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik ka ndër të tjera, një nga objektet kryesore dhe të rëndësishme të veprimtarisë së saj, mirëmbajtjen e shtresave asfaltike rrugore në të gjithë territorin e Bashkisë së Tiranës. Në funksion të kësaj veprimtarie AK-ja disponon një impiant për prodhimin e asfaltit, ku solari është një nga materialet e domosdoshme dhe kryesore për prodhimin e tij. Drejtoria prodhon asfalt në mënyrë të vazhdueshme dhe nevoja për solar është shumë e shpeshtë, me frekuencë mesatarisht 3-4 herë në javë, ka raste dhe çdo ditë. Sqarojmë se AK-ja nuk disponon mundësi magazinimi sipas kushteve teknike për këtë mall dhe specifika e procesit të prodhimit të asfaltit kërkon malli në momentin e çdo lëvrimi që kryhet pranë AK-së.

Si rrjedhim, AK-ja gjykon se vetëm marrëveshja kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara është e përshtatshme pasi për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, lëvrimi i mallit nga operatorë të ndryshëm nuk është i favorshëm, sepse do të shkaktonte vështirësi AK-së duke u shoqëruar me kosto shtesë, vonesa në kryerjen e furnizimit dhe si rezultat mosrealizimin e prodhimit sipas objektivave të AK-së.

2.Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE (pra rrjedhimisht ku jo të gjitha kushtet do të ishin të përcaktuara) do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me rritjen e afateve të lëvrimit duke patur parasysh nevojën për këtë mall nga ana e AK-së. Lidhja e MK me një OE të vetëm, do të shoqërohej me mirëorganizimin e këtij të fundit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

Gjithashtu, theksojmë se marrëveshja kuadër me disa OE ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara nuk konsiderohet kontratë. Kjo do të thotë që AK-ja nuk kanë mekanizma detyruese për OE të shpallur të suksesshëm për pjesëmarrjen e tyre në minikonkurse dhe rrjedhimisht në lidhjen e kontratave pas zhvillimit të tyre. Pasiguria dhe vonesat mund të sjellin dështim në furnizim, duke patur impakt direkt në veprimtarinë e AK-së.

Si përfundim, me qëllim garantimin e furnizimit në afatet kohore të përcaktuara, MK me një OE të vetëm fitues do të garantonte sigurinë e furnizimeve sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK.

Ndërsa në pikën 2.11.1, po këtu, është parashikuar si vijon:

#### **2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:**

**Kohëzgjatja në muaj: 24 njëzet e katër muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.**

III.1.4. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Trios” SHA ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë vijon:

1. Deklaratë, me anë të së cilës, administratori i i operatorit ekonomik “Trios” SHA deklaron se subjekti që ai administrion disponon depozita në pronësi të shoqërisë “Trios” SHA, provuar me certifikatë pronësie dhe që janë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrit tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me adresë: Njësia Administrative Vaqar. Fshati Sharrë, ZK nr.3321, Pasuria 343/16, Rethi Tiranë.
2. Çertifikatë për vërtetim pronësie nr. 1695187, për pasurinë e paluajtshme ndërtesë Z.K nr. 3321, Nr Pasurie 343/16/ND, me sipërfaqe 1675 m2, harta treguese dhe foto të depozitave. Në kartelën e pasurisë në përshkrimin e vecantë thuhet: Depo karburanti +zyra 2 kat = 90 m2; Sip depo karburant aksesor 1585 m2

3. *Ekstraktin Historik Tregëtar të datës 26.01.2026, ku në rubrikën vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit, përvec të tjerave, rezulton edhe adresa: “Vaçar SHARRE Sharre, Zona Kadastrale 3321, Nr Pasurie 343/16”, Tiranë.*
4. *Licencë me kategorinë VIII.1.A me veprimtari: Tregtim me shumicë i Solar kategoria IV/B, Bitum kategoria V/A, Mazut kategoria V/B, me vend të kryerjes së veprimtarisë në adresën “Vaçar Sharre, Zona Kadastrale 3321, Nr Pasurie 343/16”, Tirane;*
5. *Leje Mjedisore me kategori III.1.B me veprimtari: Shperndarja dhe magazinimi i naftës dhe nenprodukteve të saj...etj, me adrese “Vaçar SHARRE Sharre, Zona Kadastrale 3321, Nr Pasurie 343/16”, Tirane;*
6. *Vërtetim Teknik nr.serial VT 3823, datë 03.02.2026, lëshuar nga Organi i Miratuar “Sëiss Aproval Albania” shpk, OMVK 011, me emërtim të pajisjeve: “Depozitim & Tregëtim me shumicë i nënprodukteve të naftës”, [...] kategoria V/B “Mazut” etj, kapaciteti 50 m3, vlefshmëria 03.02.2027;*
7. *Çertifikatë Për Sigurinë nga Zjarri, datë 15.09.2023, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH;*
8. *Policë Sigurimi nr. Serial 251202922, datë 20.05.2025, lëshuar nga ALBSIG sh.a.*
9. *Raport testimi nr.737/2 prot., datë 23.01.2026 lëshuar nga ISHTI për lëndën djegëse “Mazut” për subjektin “Trios” SHA.*

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

III.1.6. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 8 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.7. Neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*9 Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë*

*organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.1.8. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, përcaktohet se:

*“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.1.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për 14 përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.10. Lidhur me pretendimin e ankimuesit sa i përket kapaciteteve depozituese të operatorit ekonomik “Trios” SHPK, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit sikurse përmendëm edhe më sipër, rezulton se është kërkuar që operatori ekonomik të vërtetojë kapacitetet depozituese dhe rezervat e tij, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Pra, nga ana e autoritetit kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është kërkuar në asnjë rast që ofertuesit të disponojë kapacitete depozituese sa kërkesat për mazut për 2 vjet që do të zgjatë marrëveshja kuadër, (447,518 kg), kërkesë e cila do të përbënte detyrim për t’u përmbushur nga ofertuesit. Rezulton se e gjithë sasia e lëndës djegëse do të lëvrohet për 24 muaj, dhe nevoja për të, do të jetë me frekuencë mesatarisht 3-4 herë në javë, ka raste dhe çdo ditë.

Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por cenon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.1.11. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “*Operatori TRIOS duhet të ishte skualifikuar për mosplotësim të kriterit: 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizë për mallin objekt prokurimi, të lëshuar nga ISHTI ose nga laborator i akredituar, e cila duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve nga data e hapjes së ofertave*” Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e kërkesës në fjalë nga operatori ekonomik “Trios” SHA në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

*Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se ankimuesi duhet të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë se, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për kualifikimin e padrejtë të

shoqërisë “Trios” SHA Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik, refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Resuli-Er” SHA se: *“Gjithashtu KVO nuk ka kryer verifikimin e ofertës anomalisht të ulët sipas Nenit 93 të LPP, subjekt mase administrative madje sipas nenit 132 LPP germa h) mosrespektimi i detyrimit për të kërkuar shpjegime për ofertën anomalisht të ulët nga operatori ekonomik sipas nenit 93, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë si dhe sipas Nenit 82, pika 4 i RPP ku për rastin e dy ofertave të sukseshme formula është Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur; Ky është një detyrim për çdo procedurë prokurimi pavarësisht vecantise apo objektit, pasi në asnjë nen të ligjit LPP apo VKM RPP nuk gjejmë asnjë përjashtim nga ky rregull. Për sa me siper, duke gjykuar me vlerësimin dhe marzhin e fitimit të operatorit TRIOS sha, 11.31 leke për kg, dhe duke marrë parasysh se sipas VKM RPP në ditën e ofertimit të gjithë operatorët i referohen të njëjtave kushte pra, bursës së ditës së shpalljes së njoftimit të procedurës dhe kursit e kete dite, rezultoni se çmimi për kg i ofruar nga ky operator është 83.526 leke për kg pa tvsh ose 100.231 leke për kg me tvsh, llogari kjo që e ben AK sipas edhe parashikimit të shtojcës 2 dhe KM RPP Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në: a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date b) elementet fiskale; c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës. PRA AK DUHET TE NXIRRTE ÇMIMIN PER NJESI DHE TE BENTE KONTROLLIN E OFERTES ANOMALISHT TE ULET, NDRYSHE PER CFARE DUHET ÇMIMI PER NJESI?! VETE AK E KA NXJERR TOTALIN NE NJOFTIMIN*

*E FITUESIT PARAPRAK, PRA DI TA BEJ SHUME MIRE LLOGARINE E OFERTES TOTALE. NE KETO KUSHTE NUK DUHET AS STUDIMI I TREGUT, AS FONDI LIMIT DHE ASGJE ME LOGJIKEN E AK.*

*Sasia e pritshme me te cilen referohemi sipas AK eshte 447518 kg, totali i ofertes eshte 37.379.388 leke pa tvsh. Fondi limit i marre ne baze te ofertave apo kontratave te meparshme eshte 54,999,962 leke pa tvsh, diferenca 32 % poshte fondit limit. Duke qene se edhe ne jemi opertor ne kete fushe, ky cmim dhe kjo oferte nuk justifikon as blerjen e produktit i cili ka nje cmim dhe nje kosto, per me teper ka transport deri ne Krrabe ku ndodhen magazinat e AK. Vete AK duhet detyrimisht te kerkonte verifikimin e kesaj suate pasi e ka informacionin e duhur lidhur me cmimin e ketij produkti dhe koston perkatese plus qe eshte detyim ligjor. Per me teper, ky cmim kaq i ulet dhe fakti se vite me pare ne shtator 2022 shoqeria TRIOS sha eshte edhe denuar per shkelje te cilesise se produkteve (dyshojme se per lende djegese) qe mendojme se edhe AK ka dijeni, duhet te ishin kembana per AK per te verifikuar me teper kete oferte jashte cdo norme logjike tregu. E lusim KSHA te bej nje verifikim te blerjeve dhe gjendjeve te ketij operatori ne ditën e ofertimit duke e krahasuar me cmimet e prodhuesve rafinerive vendase apo greke a maqedone, pasi ne e kemi bere kete analize dhe ky marzh fitimi nuk justifikon dot as blerjen. Kujtojme AK se shitja me humbje eshte e ndaluar dhe nga ligji per TVSH. Madje AK dhe KPP te marrin dhe informacion nga tatimet dhe dogana per kete produkt lidhur me vlerat e blerjes dhe shitjes se tij qofte dhe per operatorin TRIOS ne vecanti per te konfirmuar se ku dhe si e gjen ky operator kete produkt me keto cmime dhe a ka gjendje apo jo qe ne fakt edhe sipas pikes me siper nuk mund te mbaj sasi me teper se aq sa lejon vertetimi teknik i tij. Bejme me dije se blerja reale e produktit mazut eshte me cmim me te larte se bursa platts dhe premio nuk eshte 30 \$ per ton ne rafinerite prodhuese sic e publikon dogana ne bursen e saj, por eshte me teper. Per sa me siper, kerkojme KSHA dhe KPP verifikimin e pretendimeve tona dhe zbatimin e ligjit per verifikimin e ofertes anomalisht te ulet subjekt edhe mase administrative per te cilen ne mungese te zbatimit do te njoftohet dhe APP per procedim te metejshem. Per referim cmimet e rafinerise SHELL CORAL ne Greqi per produktin mazut fuel oil ne ditën e hapjes se ofertave dhe shpalljes se njoftimit ne sistem, kesaj i duhet shtuar dhe kosto transporti”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

*“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose koston e propozuara në ofertë.*

*2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:*

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;*
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

III.2.2. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar, pika 4,parashikohet shprehimisht se:

Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

*MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme*

*N - Numri i ofertave të vlefshme*

*PR (Zm) – Zbritje e mundshme*

*MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N*

*PR = 85 % Mo*

*Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.*

*Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.*

III.2.3. Në përgjigjen e dhënë ankimuesit, KSHA ka sqaruar se: “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vepruar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe me natyrën specifike të procedurës së prokurimit, pasi në rastin e furnizimit me mallra burse, si mazuti, struktura e çmimit nuk lihet në vullnetin e lirë të operatorëve ekonomikë, por është e standardizuar dhe e përcaktuar paraprakisht nga mekanizmi ligjor përkatës. Në këtë lloj procedure, çmimi i kontratës nuk përbën një ofertë të lirë për njësi, por rezulton nga një formulë e detyrueshme që përfshin çmimin e bursës dhe elementët fiskalë, të cilët janë objektivë, të njëjtë dhe të pandryshueshëm për të gjithë operatorët, duke bërë që elementi i vetëm konkumies të mbetet norma e fitimit e deklaruar prej tyre. Për rrjedhojë, vlerësimi i kryer mbi normën e fitimit përbën në vetvete vlerësimin e çmimit të ofertës, ndërsa çmimi për njësi është thjesht një derivat teknik i kësaj norme, i përllogaritur sipas formulës ligjore dhe jo një komponent i pavarur që mund të vlerësohet veçmas. Në këtë kontekst, edhe analiza e ofertës anomalisht të ulët duhet të interpretohet në mënyrë funksionale dhe në përputhje me natyrën e këtij mekanizmi çmimor. Ndryshe nga procedurat klasike, ku operatorët kanë liri të plotë në formimin e çmimit dhe një ulje e ndjeshme mund të sinjalizojë rrezik për mosrealizim të kontratës, në rastin e mallrave të bursës një diferencë e konsiderueshme nga fondi limit nuk buron nga një çmim i ulur, por nga një normë fitimi më e ulët e pranuar nga operatori mbi një bazë çmimi të fiksuar nga tregu dhe legjislacioni fiskal. Për sa kohë kjo normë fitimi rezulton pozitive dhe nuk provon një situatë të qartë të shitjes nën kosto, ajo nuk cenon realizueshmërinë ekonomike të kontratës dhe nuk përbën, në vetvete, shkak për skualifikim. Për më tepër, edhe nëse do të konsiderohej se duhej ndjekur formalisht procedura për kërkimin e shpjegimeve mbi ofertën anomalisht të ulët, mungesa e një hapi të tillë nuk prek vlefshmërinë e procedurës apo të vendimit të KVO-së, pasi legjislacioni parashikon pasoja administrative për autoritetin kontraktor dhe jo pavlefshmëri automatike të vendimmarrjes. Në kushtet kur çmimi është formuar në mënyrë të detyrueshme sipas formulës ligjore për mallrat e bursës, norma e fitimit e ofertës fituese është pozitive dhe e krahasueshme me praktikën e tregut, si dhe vlerësimi është kryer mbi të vetmin element konkurrues në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët, rezulton se analiza e KVO-së ka qenë materiale, reale dhe e mjaftueshme për të garantuar ligjshmërinë e procedurës. Në procedurën në fjalë, objekt prokurimi është një mall burse (mazut), për të cilin, në zbatim të nenit 45/2.1 të VKM nr. 285/2021 dhe Shtojcës 2 të dokumenteve standarde, çmimi i kontratës nuk

*ofertohet lirisht si çmim për njësi, por përlllogaritet nga autoriteti kontraktor mbi bazën e çmimit të bursës në datën e publikimit të njoftimit, elementëve fiskalë dhe normës së fitimit të shprehur në vlerë absolute, të deklaruar nga operatori ekonomik. Si rrjedhim, elementi i vetëm konkurrues midis operatorëve është norma e fitimit, ndërsa komponentët e tjerë të çmimit janë të unifikuar dhe të njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit. Për rrjedhojë, pretendimi se nuk është kryer një vlerësim i drejtë i çmimit apo se oferta duhet të konsiderohet anomalisht e ulët për shkak të diferencës me fondin limit nuk qëndron, pasi në këtë lloj prokurimi “çmimi” identifikohet me normën e fitimit dhe kontrolli i arsyeshmërisë së saj zëvendëson analizën klasike të kostove. Në këto kushte, përzgjedhja e ofertës me normën më të ulët të fitimit si oferta ekonomikisht më e favorshme është rezultat i një vlerësimi të kryer në përputhje me ligjin, me natyrën e tregut dhe me parimet e konkurrencës efektive, duke mos u cenuar nga pretendimet për moszbatim formal të mekanizmit të ofertës anomalisht të ulët.”*

III.2.4. Referuar ankesës së paraqitur, informacionit të autoritetit kontraktor si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-73740-01-09-2026, me objekt: “*Blerje lëndë djegëse për përdorim teknik, civil dhe industrial*”, me fond limit 54,999,962 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë, kanë ofertuar 2 operatorë ekonomikë të cilët rezultojnë se përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të vlefshme, në respektim të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar. Në përputhje me nenin nenin 82 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, i ndryshuar, pika 4, oferta vlerësohet anomalisht e ulët në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, dhe kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “*Trios*” SHPK rezulton se nga ana e tij është ofertuar me marzhin e fitimit në vlerë absolute 11.31 lekë/kg dhe çmimi total i ofertës pa TVSH, sipas Formularit të Ofertës dhe listës së çmimeve, është 38.798.020 lekë.

Nga përlllogaritjet e kryera nga KPP, konstatohet, se oferta ekonomike e operatorit ekonomik “*Trios*” SHA, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët, pasi vlera e saj është ulur më shumë se 25% e fondit limit.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i

njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Gjithashtu, është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë *mundësinë* e tyre për të përfutur ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e furnizimit në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e kontratës brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e furnizimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se, referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “*Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.

Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe *mundësinë* për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është vepruar sipas parashikimeve ligjore e nënligjore të sipërcituar, lidhur me trajtimin e ofertës anomalisht të ulët, por është gjykuar për specifikën që ka ofertimi i lëndëve djegëse, pa i kërkuar sqarime shoqërisë “Trios” SHA.

Sa më sipër arsyetuar KPP vlerëson se autoriteti kontraktor, me mungesën e veprimit lidhur me hapat procedural që duhet të ndiqte për konstatimin e ofertës anomalisht të ulët te operatorit ekonomik “Trios” SHA, nuk ka vepruar konform parashikimeve të akteve ligjore dhe rregullatore në fuqi për prokurimin public. Autoriteti kontraktor kishte detyrimin t’i kërkonte ofertuesit të kualifikuar i pari, oferta e të cilit në aplikim të formulës ka rezultuar anomalisht e ulët, dorëzimin e shpjegimeve për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë sipas parashikimeve të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se procedura e prokurimit objekt ankimi duhet të rikthehet dhe të vlerësohet oferta anomalisht e ulët e operatorit ekonomik “Trios” SHPK në përputhje me parashikimet e nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “RESULI-ER” SHA, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-73740-01-09-2026, me objekt: “Blerje lëndë djegëse për përdorim teknik, civil dhe industrial”, me fond limit 54,999,962 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor të kthejë për rivlerësim procedurën dhe të ndjekë hapat procedural ë që parashikon neni 93 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar për trajtimin e ofertës anomalisht të ulët të operatorit ekonomik “Trios” SHA.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Resuli-Er” SHA,.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

